



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 6 mars, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* publikoi Vendimin më të fundit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave ku përshkruan mënyrën sesi viktimat mund të marrin pjesë në procesin gjyqësor. Trupi Gjykses gjithashtu vendosi se personat që kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar mund të vazhdojnë të parashtojnë kërkesë të marrin pjesë në procesin gjyqësor si viktima deri pasi Prokuroria të ketë përfunduar paraqitjen e provave të veta. Aktualisht janë tetë viktima pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Trupi Gjykses më 6 mars vendosi t'i përcillte Mbrojtjes pjesët përkatëse të formularëve të kërkesave të dëshmitarëve me status të dyfishtë, që janë në grupin e dymbëdhjetë dëshmitarëve të parë që synon të thërrasë Prokuroria. Dëshmitar me status të dyfishtë konsiderohet një dëshmitar që është edhe viktimitë pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore. Trupi Gjykses e çmoi të nevojshme ta jepte këtë informacion për të garantuar zhvillim të drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Administratorja njoftoi Trupin Gjykses se ka caktuar katër avokatë të përfaqësojnë individët të cilëve iu rrëzua kërkesa për të marrë pjesë si viktima pjesëmarrëse, në bazë të Vendimit të Pestë të Trupit Gjykses mbi Pjesëmarrjen e Viktimave. Individët që parashtuan kërkesë për të qenë viktima pjesëmarrëse në procesin gjyqësor dhe të cilëve nuk iu pranua kërkesa nga Trupi Gjykses, kanë të drejtën t'u caktohet avokat dhe të apelojnë vendimin.

Më 2 mars, Trupi Gjykses rrëzoi mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për të ulur numrin e akuzave në Aktakuzë, duke vënë në dukje , ndër të tjera, se rishtazi e kishte ftuar Prokurorinë të ngushtonte kuadrin e akuzave në Aktakuzë.

Pyetje nga gazetarët

